



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 8 nëntor 2021
Nr. ref.:RK 1886/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI58/21

Parashtrues

Sylë Krasniqi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme,
PA-II-4/2020, të 3 janarit 2020**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Sylë Krasniqi (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), me vendbanim në fshatin Dubravë, komuna e Suharekës, i cili përfaqësohet nga Mustafë Musa, avokat nga Gjilani.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, PA-II-4/2020, të 13 dhjetorit 2020, në ndërlidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit APS. nr. 22/2020, të 20 korrikut 2020.
3. Aktgjykimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës, më 5 shkurt 2021.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 23 mars 2021, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 29 mars 2021, Kryetarja e Gjykatës, Arta Rama-Hajrizi, caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama Hajrizi (kryesuese), Safet Hoxha dhe Remzije Istrefi-Peci (anëtarë).
8. Më 31 mars 2021, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje e kërkesës, në pajtim me Ligjin iu dërgua Gjykatës Supreme.
9. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP.71-2/21, u përcaktua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, detyrën e Kryetares së Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, më 26 qershor 2021.
10. Më 8 qershor 2021, Kryetarja e Gjykatës me vendimin GJR.KI58/21 caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi gjyqtar raportues, në vend të gjyqtares Gresa-Caka Nimani, e cila më 17 maj 2021 u zgjodh Kryetare e Gjykatës.

11. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP.71-2/21, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtarës së Gjykatës Kushtetuese.
12. Më 28 qershor 2021, Kryetarja e Gjykatës Gresa Caka-Nimani, me vendimin nr. KSh.KI/21 për zëvendësimin e gjyqtarëve në kolegje shqyrtuese, caktohet anëtare e Kolegjit shqyrtues në vend të ish-kryesueses së kolegjit Arta Rama-Hajrizi.
13. Më 21 tetor 2021, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë që ta deklarojë kërkesën të papranueshme, si qartazi të pabazuar.

Përmbledhja e fakteve

14. Kërkesa ka të bëjë me çështje penale, gjegjësisht me një aktakuzë të ngritur nga Prokuroria Speciale, kundër parashtruesit të kërkesës dhe të disa të bashkakuzuarve tjerë për kryerjen e veprës penale të “kontrabandimit me migrantë” dhe “pjesëmarrjes së organizuar në grupet të organizuara kriminale”, në lidhje me organizmin e kontrabandimit.
15. Më 19 nëntor 2014, Prokuroria Speciale ngriti aktakuzën PPS.nr.05/2014, kundër parashtruesit të kërkesës për shkak të kryerjes së veprës penale së, “pjesëmarrjes në organizimin e grupit kriminal, nga neni 283 paragrafi 1, lidhur me veprën penale të “kontrabandimit me migrantë”, nga neni 170, paragrafi 6, lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPRK).
16. Më 6 janar 2020, Gjykata Themelore në Prizren, me Aktgjykimin PKR. nr. 26/2016, parashtruesin e kërkesës e liroi nga të gjitha aktakuzat, me arsyetimin se, *“trupit gjykues ka vepruar sipas rekomandimeve të Gjykatës së Apelit, me dëgjimin e serishëm të dëshmitarëve I. O, L. Sh, N. S, Sh. Sh, S. M, M. L dhe I. R, me deklaratat e tyre dhënë posaçërisht gjatë shqyrtimit kryesor, eliminoi të gjitha kundërthëniet dhe deklaratat kontradiktore të dëshmitareve të dhëna në procedurën paraprake e duke pasur parasysh edhe mbrojtjen e të akuzuarve, erdhi në përfundim se të akuzuarit A.S dhe Sylë Krasniqi duhet të lirohen nga aktakuza për veprën penale pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar nga neni 283 par. 1 lidhur me veprën penale kontrabandim me migrantë nga neni 170 par. 6 lidhur me par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.”*
17. Më 14 shkurt 2020, Prokuroi Special ushtroi të drejtën e ankesës në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, të 6 janarit 2020, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit material dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, duke kërkuar anulimin e Aktgjykimit të shkallës së parë dhe kthimin e lëndës në rivendosje. Në mbështetje të këtij propozimi ishte dhe Prokuroria e Apelit. Kundër ankesës së Prokurorit Special, përgjigje ushtruan mbrojtësi i parashtruesit të kërkesës dhe

i të akuzuarit A. S., të cilët kërkuar vërtetimin e Aktgjykimit të atakuar si të drejtë dhe të bazuar në ligj.

18. Më 20 korrik 2020, Gjykata e Apelit, me Aktgjykimin APS. nr. 22/2020, bazuar në ankesën e Prokurorit Special dhe sipas detyrës zyrtare, ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren, duke e shpallur fajtor parashtruesin e kërkesës për veprën penale të ngarkuar dhe duke e dënuar atë me burgim efektiv në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vitesh dhe me dënim me gjobë në shumën prej 8000 mijë euro. Gjykata së Apelit arsyetimin për gjetjen fajtorë të parashtruesit të kërkesës e mbështetë në faktin se shkalla e parë nuk kishte bërë vërtetimin e plotë dhe të saktë të gjendjes faktike. Kjo gjykatë vlerësoi se në veprimet e të akuzuarve konsumohen elementet e veprës penale të “kontrabandim me migrantë” nga neni 170, paragrafi 6, lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, por nuk i gjen të bazuara pretendimet e Prokurorit Special se të akuzuarit kanë kryer veprën penale “pjesëmarrje në organizimin e grupit të organizuar kriminal”, nga neni 283, paragrafi 1, i KPRK-së. Parashtruesit të kërkesës me këtë rast gjykata ia kishte caktuar edhe masën e paraburgimit, meqenëse ai dhe i bashkakuzuari A. S. gjendeshin në liri.
19. Më 29 korrik 2020, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Gjykatën Supreme, kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, të 20 korrikut 2020, për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384. paragrafi 1, nënparagrafi 1.8, e 1. 12, lidhur me paragrafin 2, neni 89 paragrafin 1, neni 92 paragrafin 1, nënparagrafi 1.1, 1.2 dhe 1.4, nenin 97 paragrafin 3 lidhur me nenin 241 paragrafin 1.4 dhe 1.5, nenin 249 dhe nenin 370 paragrafin 1. 8 dhe 1.12, të KPRK-së; konstatimit të gabuar të gjendjes faktike; zbatimit të gabuar të kodit penal; vendimit për sanksionin penal dhe caktimit të masës së paraburgimit.
20. Më 3 dhjetor 2020, Gjykata Supreme, nëpërmjet Aktgjykimit PA.II. nr.4/2020, aprovoi pjesërisht ankesat e mbrojtësit të parashtruesit të kërkesës dhe të mbrojtësit të bashkakuzuarit A. S. dhe e ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit vetëm përkitazi me vendimin për dënimin, duke ia zbritur masën e dënimit prej 5 (pesë) viteve në 3 (tre) vite e gjashtë muaj, dhe duke ia zbritur gjobën prej 8000 mijë në 4000 mijë euro.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

21. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me aktgjykimet e kontestuar të gjykatave të rregullta i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, për arsytet vijuese.

Përkitazi me tejkalimin e kufijve të ankesës së Prokurorit Special

22. Parashtruesi i kërkesës pretendon se përkundër faktit që Gjykata Themelore në Prizren e kishte liruar nga aktakuza dhe se Prokurori Special kishte kërkuar vetëm anulimin e vendimit të shkallës së parë dhe jo ndryshimin e aktgjykimit, konsideron se Gjykata e Apelit ka tejkaluar kufijtë e ankesës së Prokurorit Special, sepse pa propozimin e tij e ka ndryshuar Aktgjykimin e shkallës së parë, në dëm të tij, duke e dënuar me burgim efektiv në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vitesh dhe dënim me gjobë në shumën prej 8000 mijë euro.

23. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit ishte kontestuar me ankesë në të gjithat bazat e tij në Gjykatën Supreme e cila më 3 dhjetor 2020, e ndryshon pjesërisht aktgjykimin e së njëjtës, vetëm sa i përket vendimit për dënimin duke e zbritur atë, prej 5 viteve, në 3 vite e gjashtë muaj me burgim efektiv dhe gjobën prej 8000 mijë euro në 4000 euro. Mbi këtë bazë, parashtruesi i kërkesës pretendon se edhe Gjykata Supreme nuk e ka shqyrtuar pjesën e ankesës që ndërlidhej me tejkallimet e kufijve të ankesës së Prokurorit Special, e cila kishte kërkuar vetëm anulimin e aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, por jo edhe ndryshimin e tij.
24. Prandaj, sipas tij, Gjykata e Apelit ka luajtur dy role edhe si gjykatë edhe si prokurori, nga fakti se prokurori me ankesë ka kërkuar vetëm anulimin e aktgjykimit lirues, ndërsa, gjykata e ndryshon aktgjykimin e shkallës së parë, “duke më shpallur fajtor” dhe duke më dënuar me burgim efektiv në kohëzgjatje prej 5 viteve dhe dënim me gjobë 8000 mijë euro. Parashtruesi i kërkesës tutje pretendon se përkundër kësaj shkeljeje ligjore, Gjykata Supreme në vend se ta korrigjonte shkeljen e ligjit nga ana e Gjykatës së Apelit, e njëjta ka bërë shkelje të njëjtë duke e ndryshuar aktgjykimin, vetëm sa i përket vendimit për dënimin me burgim efektiv dhe me gjobë.
25. Me këtë rast, parashtruesi pretendon se janë shkelur të drejtat e tij “për gjykim të drejtë dhe të paanshëm”, meqë gjykatat në rastin konkret e kanë luajtur një pjesë të rolit të prokurorit, duke i tejkalluar kompetencat e tyre, ku parashihet se gjykata më e lartë nuk mund ta shqyrtoj aktgjykimin e gjykatës më të ulët jashtë kufijve të përcaktuar me ankesë. Përkritazi me këtë argument, parashtruesi i është referuar faqes 937, rreshtit 6-14 të komentarit të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Përkritazi me mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor pa praninë e të akuzuarve

26. Këtë pretendim parashtruesi i kërkesës e ka ngritur në kuadër të zgjidhjes së kërkuar me kërkesë, duke kërkuar nga Gjykata të konstatohet që: “...aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, në Prishtinë, APS.nr.26/2020, i datës 20.07.2020 dhe aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, PA. II. nr. 4/2020 i datës 3 dhjetor 2020, janë marrur me shkelje flagrante të së Drejtës për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm, sipas dispozitës së nenit 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në dëm të të akuzuarit Sylë Krasniqi, nga fsh. Dobrevë, komuna e Suharekës. Në rastin konkret, Gjykata e Apelit ka qenë e detyruar të mbaj shqyrtimin gjyqësor dhe t’i ketë të pranishëm edhe të akuzuarit, ndërsa në rastin konkret në mungesë ka gjykuar të akuzuarin tjetër në këtë lëndë, Admir Sopaj, që është në kundërshtim me Dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.”

Pranueshmëria e kërkesës

27. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të parashikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

28. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 4, të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

Neni 113
[Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara]

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

[...]

29. Gjykata në vazhdim shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen tutje në Ligj, përkatësisht me nenet 47, 48 dhe 49 të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht...”

30. Përkitazi me përmbushjen e kriterëve të lartcekura, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës: i. legjitimohet si palë e autorizuar, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës; ii. ai konteston kushtetutshmërinë e një akti të autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimin PA-II-4/2020 të Gjykatës Supreme, të 3 dhjetorit 2020; iii. ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, në kuptim formal-procedural, sipas nenit 113. 7 të Kushtetutës dhe nenit 47 të Ligjit; iv. ka specifikuar qartë të drejtat e garantuara me Kushtetutë, të cilat pretendohet se i

janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit; dhe v. kërkesën e ka parashtruar brenda afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh, siç parasheh neni 49 i Ligjit.

31. Megjithatë, përveç kësaj Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë], përkatësisht me nënregullin (1) (b) dhe (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës, që përcaktojnë:

(1) *“Gjykata mund ta konsideroj një kërkesë të pranueshme, nëse:*

[...]

(b) janë shterur të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj kundër aktgjykimit ose aktvendimit të kontestuar;

[...]

(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

32. Bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si *“qartazi e pabazuar”* në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si *“pretendime qartazi të pabazuara”*. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime *“të shkallës së katërt”*; (ii) pretendime që kategorizohen me një *“mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”*; (iii) pretendime *“të pambështetura apo të paarsyetuara”*; dhe në fund, (iv) pretendime *“konfuze dhe të paqarta”* (shih rastet e GjEDNj-së, *Kemmachev kundër Francës*, Aplikimi nr.17621/91, kategoria (i), *Mentzen kundër Lituanisë*, Aplikimi nr. 71074/01, kategoria (ii) dhe *Trofimchuk kundër Ukrainës*, Aplikimi nr. 4241/03, kategoria (iii)).
33. Gjykata rikujton se esenca e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës ka të bëjë me shkeljen e të drejtës për “gjykim të drejtë” të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në ndërlidhje me 1) tejkalimin e kufijve të ankesës së Prokurorit Special, dhe 2) mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor pa praninë e të akuzuarve.
34. Gjykata në vlerësimin e këtyre pretendimeve, do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
35. Gjykata rikujton përmbajtjen e nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.”
[...]

36. Përveç kësaj, Gjykata rikujton gjithashtu përmbajtjen e nenit 6.1 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNj-së, i cili përcakton:

“1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë ... edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij.”
[...]

37. Gjykata rikujton se e drejta për “gjykim të drejtë dhe të paanshëm” përfshin të drejtën e qasjes në gjykatë, të drejtën për një seancë në prani të të akuzuarit, të drejtën e një personi për të mos e inkriminuar veten, barazinë e palëve, të drejtën për procedurë ballafaqese me palën kundërshtare dhe të drejtën për një vendim të arsyetuar.

i. Vlerësimi i Gjykatës përkitazi me tejkalimin e kufijve të ankesës së Prokurorit Special

38. Në lidhje me këtë pretendim, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës argumenton se aktgjykimet e gjykatave të rregullta shkelin të drejtën e tij për gjykim të drejtë, sepse fillimisht Gjykata e Apelit ka vendosur jashtë kufijve të ankesës së Prokurorit Special, duke qenë se Prokurori Special kishte kërkuar vetëm anulimin e aktgjykimit, por jo edhe ndryshimin e tij. Tutje, parashtruesi i kërkesës pretendon se të njëjtën shkelje e ka përsëritur edhe Gjykata Supreme, duke mos e trajtuar çështjen e tejkalimit të kufijve të ankesës së Prokurorit Special, dhe duke u marrë vetëm me vendimin për dënimin (sanksionin penal).
39. Për më tepër, në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës thekson se gjykatat në rastin konkret e kanë luajtur një pjesë të rolit të prokurorit, duke i tejkaluar kompetencat e tyre, ku parashihet se gjykata më e lartë nuk mund ta shqyrtoj aktgjykimin e gjykatës më të ulët jashtë kufijve të përcaktuar me ankesë. Përkitazi me këtë argument, parashtruesi i kërkesës i është referuar faqes 937, rreshtit 6 -14 të komentarit të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.
40. Në këtë kontekst, Gjykata i referohet shkresave të lëndës, respektivisht ankesës së 29 korrikut 2020 dhe vëren se ky pretendim konkret nuk është ngritur në Gjykatën Supreme, andaj ajo nuk mund të ishte objekt i trajtimit pranë asaj gjykate, aq më tepër të pretendohet se mostrajtimi i këtij pretendimi nga Gjykata Supreme, përbën shkelje të gjykimit të drejtë, sipas nenit 31 të Kushtetutës. Për më tepër, ky pretendim nuk mund të trajtohet as nga Gjykata Kushtetuese, sepse nuk janë përmblusur kriteret e pranueshmërisë për shqyrtimin meritore të tij, për shkak të mosshterimit të mjeteve juridike, respektivisht ngritjes së shkeljes në substancë në gjykatat e rregullta.

41. Gjykata thekson se shterimi i mjeteve juridike ngërthen në vete dy elemente: (i) atë të shterimit në kuptimin formal-procedural, që nënkupton detyrimin e përdorimit të mjetit juridik kundër një akti të një autoriteti publik, në një instancë më të lartë me juridiksion të plotë; dhe (ii) shterimin e mjetit në kuptimin substancial, që nënkupton raportimin e shkeljeve kushtetuese në “*substance*” para gjykatave të rregullta, në mënyrë që këto të fundit të kenë mundësinë e parandalimit dhe të korrigjimit të shkeljes së të drejtave të njeriut të mbrojtura me Kushtetutë dhe KEDNJ. Gjykata i konsideron si të shterura mjetet juridike vetëm atëherë kur parashtruesit e kërkesës i kanë shfrytëzuar ato në të dyja kuptimet, në pajtueshmëri me ligjet në fuqi (shih rastet e Gjykatës Kushtetuese, KI71/18, parashtrues *Kamer Borovci, Mustafë Borovci dhe Avdulla Bajra*, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 nëntorit 2018, paragrafin 57; KI119/17, parashtrues *Gentian Rexhepi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 3 majit 2019, paragrafin 73; dhe rastin KI154/17 dhe 05/18, cituar më lart, paragrafin 94).
42. Gjykata, në këto rrethana thekson se ajo tashmë ka një praktikë të konsoliduar përkitazi me shterimin e mjeteve juridike në kuptimin substancial (shih, në këtë kontekst, ndër të tjera rastin e Gjykatës KI154/17 dhe KI05/18, me parashtrues *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Barbas”*, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 gushtit 2019, paragrafët 90-96, dhe së fundmi rastin KI189/19, parashtrues *Alban Miftaraj*, Aktvendimi për papranueshmëri i 10 nëntorit 2019, paragrafët 49-59).
43. Aspekti i shterimit të mjeteve juridike në substancë është i përcaktuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës dhe nënkupton që pretendimet për shkelje të KEDNJ-së dhe të Kushtetutës, duhet të jenë ngritur “*të paktën në substancë*” para gjykatave të rregullta në mënyrë që të njëjtave t’u jetë dhënë mundësia për të adresuar pretendimet për shkelje përkatëse (shih, Gjykata Kushtetuese, rasti KI01/19, parashtrues: *Fatos Rizvanolli*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 2 shtatorit 2020, paragrafët 96-100 dhe referencat e cituara në këtë rast).
44. Në këtë drejtim, GJEDNJ gjithashtu përcakton që parashtruesit e kërkesave nuk mund të lirohen nga detyrimi i shterimit të mjeteve efektive juridike edhe nëse gjykatat e rregullta mund të kenë qenë të detyruara të shqyrtojnë vet (*ex officio*) pretendimet përkatëse (shih, për më tepër përkitazi me shterimin e mjeteve juridike në kuptimin substancial, Udhëzuesin e GJEDNJ-së, Kriteret e pranueshmërisë, të 30 prillit 2019, Pjesa I. Bazat Procedurale të papranueshmërisë; A. Mosshterimi i mjeteve juridike; 2. Aplikimi i rregullit; d. Pretendimet e Ngritura në Substancë).
45. Për më tepër, GJEDNJ mban qëndrimin se mjeti juridik duhet të shfrytëzohet, për aq sa ekziston një mjet i tillë që ua mundëson gjykatave të rregullta të adresojnë të paktën në substancë argumentin për shkelje të një të drejte. Nëse ankesa e paraqitur në Gjykatë nuk është ngritur pranë gjykatave të rregullta, qoftë në mënyrë eksplicite apo në substancë, kur ka mundur të ngrihet nga parashtruesi i kërkesës gjatë ushtrimit të një mjeti juridik në dispozicion, atëherë gjykatave të rregullta u është mohuar mundësia e adresimit të çështjes, mundësi kjo të cilën synon ta ofrojë rregulli për shterimin e mjeteve juridike (shih rastin e GJEDNJ-së, *Jane Nicklinson kundër Mbretërisë së Bashkuar dhe*

Paul Lamb kundër Mbretërisë së Bashkuar, cituar më lart, paragrafi 90 dhe referencat e përfshira aty; dhe shih, gjithashtu, rastin e Gjykatës, KI119/17, cituar më lart, paragrafin 72, dhe së fundmi rastin KI189/19, parashtrues *Alban Miftaraj*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 10 nëntorit 2019, paragrafët 49-59)

46. Gjykata dëshiron të rikujtojë, se përjashtimi nga detyrimi i shterimit të mjeteve juridike vjen në shprehje vetëm atëherë kur Gjykata bindet se shfrytëzimi i mjetit juridik përkatës mund të mos jetë efektiv në dhënien e një përgjigjeje të arsyetuar një pretendimi për shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë. Në rastin konkret mjeti juridik në Gjykatën Supreme është ushtruar nga vetë parashtruesi i kërkesës dhe se pretendimi i tij ishte brenda fushëveprimit të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6.1 të KEDNj-së, i cili i obligon gjykatat e rregullta, sipas nenit 53 dhe 102 të Kushtetutës, t'i japin përgjigje parashtruesve të kërkesës në të gjitha fazat e procedurës, deri në përfundimin e çështjes. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës e ka lëshuar një mundësi të tillë, duke mos e ngritur shkeljen e gjykimit të drejtë në Gjykatën Supreme.
47. Andaj, duke i marrë parasysh shtjellimet e mësipërme, Gjykata konkludon se parashtruesi i kërkesës nuk i ka dhënë mundësinë Gjykatës Supreme të adresojë këtë pretendim dhe të korrigjojë shkeljen e pretenduar të së drejtës për gjykim të drejtë. Rrjedhimisht, kërkesa e parashtruesit të kërkesës në këtë pjesë deklarohet e papranueshme në pajtueshmëri me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47.2 të Ligjit dhe regullin 39 (1) (b) të Rregullores së punës.

ii. Vlerësimi i Gjykatës përkitazi me mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor pa praninë e të akuzuarve

48. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës përkitazi me këtë pretendim thekson se Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, APS. nr. 26/2020, i 20 korrikut 2020 dhe Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, PA. II. nr. 4/2020, i 3 dhjetorit 2020, janë marrë me shkelje flagrante të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, sipas dispozitës së nenit 31 të Kushtetutës, në dëm të tij. Kjo për faktin se Gjykata e Apelit ka qenë e detyruar të mbaj shqyrtimin gjyqësor dhe t'i ketë të pranishëm edhe të akuzuarit, ndërsa në rastin konkret në mungesë ka gjykuar të akuzuarin tjetër në këtë lëndë, A.S., që është në kundërshtim me dispozitat e KPRK-së.
49. Gjykata përkitazi me këtë pretendim specifik, i referohet pjesëve relevante të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit (pjesa II, par.5), ku theksohet: *"Gjykata e Apelit në mbështetje të nenit 390 ka caktuar seancën e kolegjit dhe ka ftuar palët në të cilën seancë të kolegjit, nuk ka prezantuar prokurori i Apelit, dhe po ashtu nuk kanë prezantuar as i akuzuari A.S. dhe mbrojtësi i tij av. B.T., ndërsa në seancë ka prezantuar i akuzuari Sylë Krasniqi dhe mbrojtësi i tij av. A.B."*
50. Gjykata po ashtu i referohet edhe pjesëve relevante të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme dhe vëren se në aktgjykimin e saj theksohet: *"Kolegji i veçantë e caktoi seancën e kolegjit në pajtim me dispozitën e nenit 390 par. 1 të KPP-së, në të cilën morën pjesë i akuzuari Sylë Krasniqi dhe mbrojtësi i tij avokati Mustafë Musa i angazhuar në këtë fazë ankimore dhe mbrojtësi i të akuzuarit Admir Sopaj avokati Berat Tmava. Të akuzuarit Admir Sopaj njoftimi për seancë nuk ka mundur t'i dërgohet ngase sipas konstatimit në fletkthesë gjendet jashtë"*

vendit, kurse mbrojtësi i tij u pajtua që seanca të mbahet pa praninë e tij. Kurse, Prokurori i Shtetit edhe pse i njoftuar me rregull nuk mori pjesë në seancë, mirëpo, me parashtrës të shkrim PPA.III:nr.10/2020 datë 24 gusht 2020 dhe PPA.III.nr.10/2020 datë 5.10.2020 ka propozuar që ankesat të refuzohen si të pabazuara. Mbrojtësit e të akuzuarve pasi që sqaruan disa nga pretendimet ankimore i mbështetën propozimet e bëra në to, kurse i akuzuari Sylë Krasniqi i mbështeti pretendimet e mbrojtësit të tij”.

51. Nga si u tha më lart, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës është ftuar në mënyrë të rregullt për të marrë pjesë në seancat e kolegjeve të shqyrtimit gjyqësor, si nga Gjykata e Apelit ashtu edhe nga Gjykata Supreme. Për më tepër, Gjykata Supreme ka konfirmuar pjesëmarrjen e tij dhe të mbrojtësit të tij në seancën e caktuar të kolegjit. Ndërsa sa i përket pretendimit se gjykatat kanë gjykuar në mungesë të akuzuarin A.S., Gjykata vëren se kërkesa KI58/21 nuk e përmban emrin e këtij parashtruesi, andaj në rastin konkret nuk mund të ngritën pretendime për shkelje të të drejtave kushtetuese në emër të tij nga parashtruesi i kërkesës. Megjithatë, Gjykata rikujton se në Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme, potencohet se: *“Të akuzuarit A.S njoftimi për seancë nuk ka mundur t'i dërgohet ngase sipas konstatimit në fletë-kthesë gjendet jashtë vendit, kurse mbrojtësi i tij u pajtua që seanca të mbahet pa praninë e tij.”*
52. Në vlerësimin e pretendimeve që ndërlidhen me shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së, Gjykata e konsideron të rëndësishme të ritheksojë qëndrimin e përgjithshëm se “drejtësia” e kërkuar nga nenet e lartpërmendura nuk është drejtësi “substanciale”, por drejtësi “procedurale”. Në rrafshin praktik, koncepti i “drejtësisë procedurale” nënkupton: (i) mundësinë e procedurave kontradiktore/parimi i kontradiktoritetit procedural; (ii) mundësinë e palëve që në faza të ndryshme të procedurës të paraqesin argumente dhe dëshmi që i konsiderojnë të rëndësishme për rastin përkatës; (iii) mundësinë e kontestimit efikas të argumenteve dhe dëshmive të paraqitura nga pala kundërshtare; dhe (iv) të drejtën që argumentet e tyre të cilat, shikuar në mënyrë objektive, janë të rëndësishme për zgjidhjen e rastit, të dëgjohen dhe shqyrtohen nga gjykatat e rregullta në mënyrë të duhur (shih, ndër të tjera, rastin e GjEDNJ-së *Barbera, Messeque dhe Jabardo* kundër Spanjës, Aktgjykim i 6 dhjetorit 1988, paragrafi 68; dhe rastet e Gjykatës Kushtetuese: KI128/19, cituar më lart, paragrafi 58; dhe KI22/19, parashtrues i kërkesës *Sabit Ilazi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 qershorit 2019, paragrafi 42).
53. Për sa u tha më sipër, Gjykata konsideron se në rastin e parashtruesit të kërkesës, shikuar procedurën në tërësinë e saj, janë respektuar të gjitha kriteret e lartcekura, të cilat e bëjnë gjykimin të jetë në pajtueshmëri me kërkesat e nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6.1 të KEDNJ-së. Gjykata në këtë rast vëren se parashtruesi i kërkesës thjeshtë nuk është pajtuar me rezultatin e procedurës dhe të gjyimit të çështjes së tij. Megjithatë, pakënaqësia e tij nuk mund vetvetiu të ngrejë një pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë (shih, rastin e GjEDNJ-së *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat* kundër Hungarisë, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).

54. Andaj, Gjykata këtë pretendim të parashtruesit të kërkesës e kualifikon si të kategorisë (ii) që kategorizohet me një “*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*” dhe rrjedhimisht të njëjtin e shpallë qartazi të pabazuar, në baza kushtetuese.

Përfundim

55. Si përmbledhje, Gjykata lidhur me pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, konkludon se:
- i. pretendimin përkitazi me tejkalimin e kufijve të ankesës së Prokurorit special nga gjykatat e rregullta, e deklaroi të papranueshëm, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47.2 të Ligjit dhe rregullin 39 (1, b) të Rregullores së punës.
 - ii. pretendimin përkitazi me mbajtjen e seancës gjyqësore pa praninë e të akuzuarave, e kualifikon si të kategorisë (ii) që karakterizohet me një “*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*” dhe si të tillë, të njëjtin, në baza kushtetuese e shpallë qartazi të pabazuar.
56. Andaj, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesit të kërkesës në tërësinë e saj, duhet të deklarohet e papranueshme, në baza kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47.2 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (b) dhe (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, me nenin 20 të Ligjit, me rregullat 39 (2) dhe 59 (1) të Rregullores së punës, në seancën e saj të mbajtur, më 21 tetor 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Bajram Hajdari

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani

